



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 31 maj 2021

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Mocionin e Mbrojtëses për Sqarim dhe Ndryshim të Afatit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

**Mbrojtëses së parashtruesve të
kërkesave të refuzuara:**

Ani Pues

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtëses të Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”);

DUKE MARRË SHËNIM Vendimin e Parë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, ku, ndër të tjera, refuzoi kërkesat e viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 si të papranueshme;²

DUKE MARRË SHËNIM se mbrojtësja për parashtruesit e kërkesave të refuzuara (“Mbrojtësja”) u caktua më 12 maj 2021 për të ndihmuar parashtruesit e kërkesave të refuzuara “si grup” në apelimin e Vendimit prej tyre;³

PASI KA MARRË mocionin e parashtruar më 28 maj 2021 nga mbrojtësja në emër të parashtruesve të kërkesave të refuzuara - viktimat 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 - me anë të së cilës mbrojtësja kërkon sqarim në lidhje me afatin e zbatueshëm për parashtrimin e çfarëdo apeli kundër Vendimit dhe kërkon ndryshim të afatit deri më 7 qershor 2021 për dorëzimin e parashtrimit;⁴

DUKE RIKUJTUAR se, në përputhje me rregullën 113(6) të Rregullores, parashtruesit e kërkesave të refuzuara kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda 14 ditësh;

DUKE RIKUJTUAR se Gjykatësi i Procedurës Paraprake saktësoi se, në përputhje me rregullat 9(2) dhe 113(5) të Rregullores, afati për parashtrimin e apeleve në bazë të

¹ F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me Sqarimin e Afateve, 29 maj 2021.

² F00257/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Parë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat, 21 prill 2021 (“Vendimi”), para. 85(f).

³ F00293, Njoftim për Caktimin e Mbrojtësit për Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara, 12 maj 2021, para. 2.

⁴ F00001, Mocion për Sqarim dhe Ndryshim të Afatit sipas rregullës 9 (5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave, 28 maj 2021 (“Mocioni”), para. 1, 17.

rregullës 113(6) së Rregullores, fillon nga dita e parë e punës pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës mbi vendimin për refuzimin e pranimit;⁵

GJITHASHTU DUKE RIKUJTUAR se anglishtja është gjuhë pune në këtë çështje;⁶

DUKE MARRË PARASYSH se, për hir të drejtësisë ndaj parashtruesve të kërkesave, në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores afati duhet të fillojë nga dita e parë e punës pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës mbi Vendimin në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton, e cila mund të jetë e ndryshme nga gjuha e punës në këtë çështje;

DUKE KONSTATUAR se, meqë viktimat 08/06 dhe 13/06 u njoftuan mbi Vendimin më 14 maj 2021 dhe viktimat 09/06, 10/06 dhe 11/06 u njoftuan mbi Vendimin më 17 maj 2021,⁷ rrjedhimisht afati për parashtrimin e apeleve të tyre përkatëse është më 31 maj 2021;

DUKE MARRË SHËNIM se, duket se në kohën e paraqitjes së Mocionit, viktima 14/06 nuk ishte njoftuar ende zyrtarisht mbi Vendimin;⁸

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimin e mbrojtëses se Rregullorja është e paqartë në kuptimin që nuk saktëson si duhet caktuar datën e fillimit të afatit për dorëzim të një apeli në raste kur viktimat e përfshira në një grup njoftohen në data të ndryshme;⁹

DUKE MARRË SHËNIM GJITHASHTU se mbrojtësja parashtron se nuk do të ishte as e përshtatshme e as efektive që të paraqesë apele individuale për çdo parashtrues të kërkesës së refuzuar, sepse arsyet për refuzim dhe argumentet kryesore priten të jenë të njëjta;¹⁰

⁵ F00159, Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat, 4 janar 2021, para. 55.

⁶ F00072, Vendim për gjuhën e punës, 11 nëntor 2020, para. 26(a).

⁷ Shih Mocioni, para. 6-7.

⁸ Shih Mocioni, para. 7.

⁹ Mocioni, para. 11. Shih gjithashtu Mocioni, para. 13.

¹⁰ Mocioni, para. 12.

DUKE MARRË PARASYSH se rregulla 113(6) e Rregullores nuk thotë se apelet e parashtruara nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara duhet të paraqiten bashkërisht në një parashtrim edhe pse parasheh që atyre “si grup” mund t’u caktohet një mbrojtës;

Rrjedhimisht **DUKE QARTËSUAR** se afati për parashtrim të apeleve sipas rregullës 113(6) të Rregullores fillon të llogaritet nga çdo njoftim mbi Vendimin të çdo parashtruesi të kërkesës së refuzuar;

DUKE RIKUJTUAR megjithatë, se rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e afatit të përcaktuar nga Rregullorja nëse tregohen arsye të vlefshme;

DUKE MARRË PARASYSH vështirësitë teknike me të cilat përballet mbrojtësja, përfshirë faktin që, në kohën e parashtrimit të Mocionit, mbrojtësja ende nuk kishte nivelin e nevojshëm të qasjes në *Legal Workflow*, se apeli është i pari i llojit të vet para Dhomave të Specializuara dhe për këtë arsye mund të shërbejë si precedent i rëndësishëm, dhe se në kohën e parashtrimit të Mocionit, dukej se viktimia 14/06 nuk ishte njoftuar ende mbi Vendimin;¹¹

DUKE MARRË PARASYSH se ndryshimi i kërkuar i afatit nuk do të ndikojë në procedimin në përgjithësi të kësaj çështjeje, por në fakt mund të jetë më efikas për arsye se mbrojtësja synon të parashtojë apel të përbashkët në emër të grupit të parashtruesve të kërkesave të refuzuara;¹²

¹¹ Shih Mocioni, para. 4-5, 7, 11, 14-15.

¹² Në lidhje me viktimën 14/06 në veçanti, ndryshimi i kërkuar i afatit gjithsesi do të shkurtonte afatin për parashtrimin e apelit të tij apo të saj kundër Vendimit. Duke qenë se viktimia 14/06 ende nuk ishte njoftuar zyrtarisht mbi Vendimin në kohën kur mocioni u parashtrua më 28 maj 2021, afati për parashtrimin e apelit të tij apo të saj kundër Vendimit gjithsesi do të binte pas datës të cilën mbrojtësja kërkon për apelim të përbashkët, përkatësisht 7 qershor 2021. Shoh Mocioni, para. 7, 11.

DUKE KONSTATUAR se, për arsyet e lartpërmendura, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta, ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e afatit për apelim të Vendimit;

DUKE RIKUJTUAR se, në përputhje me rregullën 9(6) të Rregullores, vendimi lidhur me një mocion për ndryshim të afateve mund të merret duke mos u dhënë palëve mundësinë e shprehjes së mendimit;

DUKE MARRË PARASYSH se afati për apelim të vendimit është shumë i afërt dhe se nuk do t'u shkaktohet padrejtësi palëve, është në interes të drejtësisë që vendimi lidhur me Mocionin të merret menjëherë;

DUKE THEKSUAR se afatet procedurale duhet të respektohen sepse janë të domosdoshme për funksionimin e duhur të Dhomave të Specializuara dhe që mbrojtësja duhet të kishte parashtruar çdo kërkesë për sqarim apo shtyrje të afatit sa më shpejt që të ishte e mundshme me qëllim që, në rast se Paneli hedh poshtë mocionin, t'i shmanget mosrespektimit të afatit të parë;

MIRATON Mocionin; dhe

URDHËRON mbrojtësen të paraqesë apelin kundër Vendimit deri më 7 qershor 2021.

/nënshkrim/

Gjykatëse Mishelë Pikar,

Kryegjykatëse

E hënë, 31 maj 2021

Në Hagë, Holandë